

Kur poeti (Gjekë Marinaj) përkthen poetin (Rainer Schulte)

NGA MJALTI I MENÇURISË NJERËZORE

*Barrën
e kalit mos ia
ngarko gomarit*

Populli

KËNDI I VJERSHËRIMIT

Etleva Tafa

Nën harqet e gurta

Shtëpia jonë ndodhet në boshtin e hënës të rrudhur ende nga dhimbjet e lindjes. Pafajësia e karafilave banon mbi tjegullat e hënës. Dhe ne banojmë po në atë qiell pa trashëgimtar Shtëpia jonë në boshtin e hënës së re. Lind në kapilarët e dhimbjeve të mia.

Puthje e kafshime gjuhë pa tinguj dashuri narciste bredhin muzgjeve mbi çati
Lakuriqësia ime ekziston vetëm si dëshirë
Pse ulurin, pusht i syve të dalldisur? kam harruar të jem vetvetja.

Fjongot e flokëve të mamasë këpucët e bardha të babait varsja me medalionin e lashtë më ngjall orën e zjarrtë kur isha fëmijë dhe akrepat e orës shënonin gjithmonë 12.

Ketrushi im me pushin e verdhë zhytej në gjoks, bënte gjumin e natës dhe klithte dëshira të marra

Ishte një çapken i kurdisur në ëndrrën time Varsja e lashtë e familjes qëndronte e varur në qafën time që herë më dukej si një lejlek mes Atlantikut herë si një dosë që qante për dhimbjet e trashëguara të botës.

Mbrëmjet familjare oshëtinin në fushën e orëve të ndaluar të qytetit të vjetër


Ndonjëherë kukulla ime qante në skaj të dy bishtalecave të mi...

Në ditët e spërkatura me parfum diellor vija kokën mbi supin tënd Isha një foshnjë që pija liqenet dhe dashuroja gjuhën e kaprollit

Tani vetëm buzët lëprij nuk qaj për netët që nuk kthehen më Sepse unë nuk të desha dhe ti nuk deshe që unë të isha për ty një kaprolle

Unë nuk jam një Penelopë megjithëse mund të doja një Odise

Në Itakë nuk kam qenë kur-rruga për te Kalorësi Itakën më rrëfen.



Rainer Schulte

NGA SKIFTER KËLLIÇI

Rainer Schulte dhe Gjekë Marinaj. Njëri nga Gjermania dhe tjetri nga Shqipëria. Rrugët e jetës i bashkojnë në Amerikë. Dhe gjejnë njeri-tjetrin në krahët e poezisë. Schulte, i njohur në botë. Marinaj, i njohur në Shqipëri. Për Schulten, poeti i madh francez, Alen Boske, shkruan: "Imazhet që krijon Rainer Schulte janë padyshim mbrojtja më e mirë kundër ndjenjës absurde. Çdo varg i tij është një shenjë shprese dhe shpengimi". Mjafton kjo poezi për të miratuar këtë përcaktim:

*"Bombat i kanë shtyrë
flakët nga rrugët
brenda dritareve.
Muret qajnë
si fëmijë të braktisur.
Pas zjarrit të madh
Rrugët kanë humbur
drejtimin
dhe kufomat mbledhin fjalë
që nuk qenë shqiptuar.
Në hi
gratë dhe fëmijët
kërkojnë heshtjen
që pat humbur
vullnetin për të folur".*


Jetojmë në kohë kur jehona tronditëse e luftërave në Lindjen e Mesme vjen deri në shtëpitë botës dhe, doemos, edhe në shtëpitë tona. Nga kjo pikë-pamje, poezia e mësipërme është shumë domethënëse. Por edhe Gjekë Marinaj krijon poezi domethënëse në krijimtarinë e tij poetike. Pesëmbëdhjetë vjet më parë ai shkruante një vjershë që mund të futet pa frikë në çdo antologji poetike botërore. Titullohet "Kuajt" dhe është botuar për herë të parë në gazetën "Drita", në Tiranë më 1989:

*Tërë jetën duke vrapuar rrimë,
Shohim veç përpara,
Ç'bëhet prapa, s'duam t'ia dimë,
Ne kemi emër. Të gjithëve kuaj, na thonë,
Nuk qajmë, nuk qeshim, heshtim, dëgjojmë,
Hamë ç'të na japin, ecim nga na thonë,
Asnjë nga ne s'është mendjehollë,
Kush qe kalë mbreti, posti qe i lartë,*



Mit'hat Frashëri (Lumo Skendo)

Shpallja e çmimit kombetar te Bibliofilise "Lumo Skendo", ne Diten Boterore te Librit me 23 prill 2006, u



Ballina e librit të përkthyer

*Kush qe kalë princeshe, i bënë shalë të artë.
Kush qe kalë fshatari, pat samar me kashtë,
Kush qe kalë i egër, tërë jetën fjeti jashtë.
Po qemë dhe mbetëm kuaj, para njeriut.*

Nëse Rainer Schulte erdhi në Amerikë serbes dhe, kur ia pati qejfi, Gjekë Marinaj erdhi nga halli, pikërisht për shkak të kësaj poezie, që desh e çoi në burg. Studioi në një kolegji në Teksas për letërsi dhe tani është pedagog i letërsisë bashkëkohore; u jep studentëve amerikanë të analizojnë edhe vepra të Kadaresë sonë të madh dhe gjen kohë të shqiptaroj Shulten e poetët të tjerë bashkëkohorë. I nisa këto shënime me një poezi të trishtë me motive lufte. Dhe përsëri me këto motive do të vazhdojë. Është koha kur lufta, sidomos ne, shqiptarëve këtu në Amerikë, na është bërë pjesë e rëndësishme e jetës së përditshme, por edhe atyre nënave e baballarëve shqiptarë që kanë djem, të cilët luftojnë në Irak e Afganistan kundër terrorizmit që kërcënon botën, kërcënon edhe Shqipërinë. Ndaj Schulte shkruan: "Në emër të fesë, / ata torturojnë tokën, / dhe shuajnë këngët e gjinkallave, / në emër të fesë, / ata kthejnë lumenjtë në gjak... / Në emër të fesë, / ata dërgojnë qilima bombash, / në xhami e muzeume, / Në emër të fesë, / ata vazhdojnë të vrasin pa fund". Këto vargje janë refreni i sa e sa pamjeve që na vinë çdo natë nëpërmjet ekranit nga ato vise ku lufta absurde është bërë qëllim në vetëvete, në emër "të asaj feje", që është kundër parimeve aq të larta që predikon Bibla dhe Kurani.

Sidoqoftë, Schulte nuk është vetëm poet batalist, nuk është poet që na trishton me pasazhet që pamë më sipër. Ai është poet poliedrik, që di t'i këndoje njeriut dashurisë, jetës.


Në poezinë "Ditët pasardhëse" ai na fut në një tjetër atmosferë, kur shkruan:

*"Trupat tanë përfaquan tejdruksh-
mërinë e pasditës, / kur petalet e ënd-
rave të së ardhmes, / rodhën prej
fytyrave tona të brishta".*

Më tutje në një poezi të goditur, ai

Rikthehet "Lumo Skendo"

kremtua gjate nje ceremonie kushtuar kesaj dite ne Biblioteken Kombetare ne Tirane, me pjesemarrjen e Ministrat te Turizmit, Kultures, Rinise dhe Sporteve, Bujar Leskaj, dhe personaliteteve te letersise shqipe, studiuerve. Themelimi i Çmimit Kombetar te Bibliofilise "Lumo Skendo" u shpall nga ministri Leskaj. Ky çmim i kushtohet figures se njohur poliedrike shqiptare, Mit'hat Frasherit, themelues i bibliofilise ne Shqiperi, nje çmim i konceptuar si nxitës i cilesise se prodhimit te librit shqip.



Gjekë Marinaj

zhytet në njëmendësinë që japin preket e dashurisë, ndaj na dhuron këto vargje:

"Brenda trupit tënd, / nevoja për të shkruar poezi, / venitet, / Trupi yt / është oqean. / Asnjë anije / s'ka për të arritur kurrë, / në bregun tënd... Kur ti vure duart mbi trupin tim, / bota krijoi një gjeografi të re. ("Poezia lakuriqe").

Siç shihet Schulte është mjeshër i rrallë i rrëfimit metaforik. Do të citoj disa vargje të tilla: "Ç'do mëngjes, / njerëzit zbulojnë vdekje, / në pragun e derës së tyre, / Madje as gurët nuk buzëqeshin më në diell... / Çdo orë pasqyron vdekjen / e një dite tjetër" (Vdekje pa mbarim).

Schulte shquhet edhe për sentenca metaforike si këto më poshtë:

"Jam i lodhur / nga njerëzit e lodhur, / Ata ecin më ngadalë, / si dielli në mesditë. ((Lodhje).

"Largësia ndërmjet meje / dhe pikurës në Luvrë, / është si ujërat e heshitura / midis dy kontinenteve". Mjaftojnë këta shembuj për të krijuar bindjen se Schulte është poet modern me shikim të qartë dhe të sigurt të realitetit që rrjedh në poezinë e tij me një ujëvarë figurash letrare shumë origjinale, të cilat na ndihmojnë të perceptojmë sa më mirë atë që ai kërkon të na përcjellë.

Ja përse studiuesi i njohur gjerman, Thomas Hoeksema shkruan për të: "Rainer Schulte krijon një univers poetik, nëpërmjet të cilit fuqia e gjuhës metaforike depërton në thellësinë impulsive të botës sonë bashkëkohore."

Dhe këtë shprehje kuptimplote na e bën edhe më të prekshme përkthimi i shqiptaro-amerikanit, Gjekë Marinaj, që erdhi këtu në Amerikë vetëm në poezinë "Kuajt" dhe brenda 15 vjetëve të qëndrimit të tij "në tokën e premtuar", arriti të botojë deri tani dy vëllime poetike e një vëllim me intervista me njerëz të mëdhenj, jo vetëm nga Shqipëria, por edhe nga bota. Dhe, tashmë në këtë vëllim ai shfaq edhe aftësitë e tij të çmueshme edhe në fushën e shqipërimin të një poeti me të vërtetë befasues, siç është Rainer Schulte.

"Libri ka qene perhere ngushelluesi dhe sheruesi i shpirtit njerzor, ndaj kjo dite eshte nje rast per t'i kthyer simbolikisht mirenjohjen librit", u shpreh ne fjalën e tij Leskaj. Ai renditi nje sere arritjesh ne fushen e librit gjate tete muajve te drejtimin te tij ne kete ministri.

Ne ceremonine e kremtimit te Dites Boterore te Librit u dhuruan per te pranishmit vepra e plote e Ibrahim Rugoves, e botuar pak kohe me pare ne Shqiperi si dhe njeri prej vellemeve te vepres se Kadaresë. (ATSH)